


HAPËSIRA PUBLIKE

NGA PRIZMI I TË RINJVE, NXËNËS TË IP SHMK "VËLLAZËRIM-
BASHKIM" ULQIN




SARA SULJEVIĆ

MSJA

Ulqin, 2026

1. HYRJE



Vizatimi: Sara Suleviq, nxënëse e vitit të II, IP SHMK "Vëllazërim-bashkim", Ulqin

Hapësira publike - hapësira për të gjithë ne

Hapësira publike është shumë më tepër se një hapësirë midis ndërtesave. Ajo përfshin rrugët dhe trotualet tona, sheshet, parqet, shëtitorët, brigjet, plazhet publike, këndet e lojërave dhe sipërfaqet e gjelbra – vende ku kalojmë çdo ditë, ku takohemi, bisedojmë, pushojmë, luajmë, merremi me sport ose thjesht shpenzojmë kohën. Hapësira publike, sipas funksionit të saj bazë, duhet t'i shërbejë qëllimit publik, të jetë e hapur, e qasshme dhe në dispozicion për të gjithë.

Cilësia e hapësirës publike ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës në një qytet. Një hapësirë e rregulluar mirë, e sigurt dhe e qasshme u mundëson njerëzve të lëvizin lirshëm, të shoqërohen dhe të ndihen pjesë e komunitetit. Është veçanërisht e rëndësishme që hapësira të tilla të jenë të disponueshme për të gjithë – fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, prindërit me karroca fëmijësh, personat me aftësi të kufizuara dhe të gjithë qytetarët e tjerë. Për këtë arsye, hapësira publike nuk është vetëm çështje e urbanizmit apo e pamjes së qytetit. Ajo është çështje barazie, përkatësie, sigurie dhe e së drejtës së çdo njeriu për të shfrytëzuar qytetin ku jeton. Hulumtimi i mëparshëm i MSJA-së tregoi pikërisht se disponueshmëria dhe qasshmëria e hapësirave publike kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit.

Hapësirat publike janë gjithashtu vende ku ndërtohet komuniteti. Ato mundësojnë takimin e njerëzve të ndryshëm, shkëmbimin e mendimeve, ndërveprimin shoqëror dhe ndjenjën e përkatësisë. Kur hapësira të tilla zhduken, bëhen të paqasshme ose përdoren vetëm në interes të individëve, qyteti humbet gradualisht vendet që u përkasin të gjithëve. Prandaj, ruajtja e hapësirës publike do të thotë edhe ruajtje e interesit publik.

Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme në Ulqin. Qyteti disponon hapësira të jashtëzakonshme natyrore dhe urbane, por njëkohësisht prej vitesh përballet me presione në lidhje me sipërfaqet publike. Hulumtimi i mëparshëm i MSJA-së ka regjistruar probleme të tilla si uzurpimi i trotuareve, parkimi në sipërfaqet që janë për këmbësorë, vështirësimi i lëvizjes dhe zvogëlimi i hapësirës së disponueshme për qytetarët. Prandaj, çështja e hapësirës publike nuk është vetëm pyetja se sa shumë kemi, por mbi të gjitha se si është ajo, kush mund ta shfrytëzojë dhe në çfarë mënyre mund ta menaxhojmë.

Në këtë rrëfim, një vend i veçantë u përket të rinjve.

Të rinjtë e përdorin qytetin çdo ditë rrugët, parqet, shëtitoret dhe sipërfaqet e gjelbra të tij, por mendimi i tyre rrallë kërkohet kur merret vendimi se si do të duken ato hapësira dhe cilës qëllim do t'i shërbejnë. Për ta, hapësira publike nuk është thjesht një sipërfaqe fizike. Ajo është një vend lirie, shoqërimi, njohjeje, sporti, krijimtari dhe mësimi jashtë shkollës e familjes. Është gjithashtu një nga të paktat vende ku ata mund të kalojnë kohën së bashku pa pasur detyrimin për të blerë apo paguar diçka.

Pikërisht nga kjo lindi publikimi „Hapësira publike nga prizmi i të rinjve: Çfarë, si dhe cilit qëllim i shërben“. Kësaj radhe dëshirojam që të mos u tregojmë të rinjve se si do të duhej të duket hapësira publike, por t'i pyesim ata. Të dalim së bashku në terren, të shohim hapësirën që tashmë ekziston dhe të përpiqemi ta vështrojmë me sytë e tyre. Çfarë u mungon atyre? Çfarë u pengon? Ku ndihen rehat dhe të sigurt? Kush mund ta shfrytëzojë një hapësirë të caktuar, e kujt i është vështirësuar qasja? Dhe, mbi të gjitha – çfarë do të ndryshonin ata?

Për këtë arsye, nxënësve të IP SHMK “Vëllazërim-bashkim” në Ulqin u është dhënë një detyrë e thjeshtë: të analizojnë hapësirat publike ekzistuese dhe të propozojnë mënyra për përmirësimin e tyre, pa ndryshime të mëdha e radikale. Zgjidhjet e tyre duhej të respektonin karakterin ekzistues të hapësirës, natyrën dhe gjelbërimin, të ishin të thjeshta dhe të qëndrueshme, por njëkohësisht funksionale, të sigurt dhe të disponueshme për të gjithë. Ky publikim paraqet idetë e tyre. Ai nuk është një plan urbanistik e as një përmbledhje projektesh të gatshme. Ai është një përpjekje për të treguar se si të rinjtë e shohin qytetin e tyre kur u japim mundësinë të mendojnë e të japin sugjerime për të.

Sepse të rinjtë nuk duhet të jenë vetëm shfrytëzues të hapësirave që të tjerët i planifikojnë për ta. Ata duhet të jenë pjesë e procesit në të cilin ajo hapësirë konceptohet. Pjesëmarrje nuk do të thotë vetëm t'i pyesësh për mendimin e tyre kur gjithçka është vendosur tashmë. Ajo do të thotë t'u mundësosh atyre të vëzhgojnë, të bëjnë pyetje, të japin sugjerime dhe, së bashku me të tjerët, të krijojnë një hapësirë sipas masës së komunitetit.

Qyteti në të cilin dëshirojmë që të rinjtë të qendrojnë, duhet të jetë gjithashtu një qytet në krijimin e të cilit ata kanë zërin e tyre.

2.HAPËSIRA PUBLIKE NGA PRIZMI I TË RINJVE



NGA VËZHGIMI I HAPËSIRËS DERI TE IDEJA VETJAKE

Si e shohin të rinjtë hapësirën publike që e shfrytëzojnë çdo ditë? Çfarë vërejnë në të, çfarë u mungon, çfarë do të mbronin e çfarë do të ndryshonin?

Pikërisht nga këto pyetje kemi nisur punën me nxënësit e IP SHMK “Vëllazërim-bashkim” në Ulqin. Si hapësirë të hulumtimit tonë të përbashkët kemi zgjedhur shëtitoren e Pyllit të Pishave, një nga zonat më të njohura të gjelbra të qytetit dhe një hapësirë që qytetarët e të gjitha gjeneratave e shfrytëzojnë për shëtitje, pushim, rekreacion, shoqërim dhe qëndrim në natyrë.

Qëllimi i punëtorisë nuk ishte që të rinjtë të “projektojnë një hapësirë të re”, por t'i nxisnim ata ta vëzhgonin më me vëmendje atë që tashmë ekziston. Dëshëm që ata të identifikonin vlerat e Pyllit të Pishave që duhen ruajtur, por edhe problemet e mangësitë që ndikojnë në mënyrën se si përdoret kjo hapësirë sot.

Për këtë arsye, së bashku vëzhguam gjendjen e shtigjeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, mundësitë për pushim, shoqërim e rekreacion, qasshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, parkimin dhe trafikun, lidhshmërinë e pjesëve të caktuara të shëtitores, si dhe sipërfaqet që nuk shfrytëzohen mjaftueshëm. Veçanërisht e rëndësishme ishte që nxënësit të mos e vëzhgonin hapësirën vetëm nga perspektiva e tyre personale, por të mendonin se kush e shfrytëzon Pyllin e Pishave dhe çfarë nevojash kanë përdoruesit e ndryshëm.

Punëtorja nisi pikërisht në Pyllin e Pishave, me një bisedë të shkurtër rreth asaj se çfarë është hapësira publike, kujt i përket dhe për çfarë duhet të shërbejë. Pas kësaj vijuan vizita, vëzhgimi dhe analiza e lokacioneve të përzgjedhura brenda zonës nën rrugë, që nga hapësira e ish-hotelit Galeb deri te zona prapa hotelit Albatros.

Më pas, të ndarë në grupe, nxënësit morën përsipër pjesë të ndryshme të kësaj zone. Ata diskutuan për atë që identifikuan në terren, definuan problemet e mundësitë dhe zhvilluan propozimet e tyre. Nga vëzhgimet e para lindën idetë, e më pas skicat dhe vizatimet përmes të cilave treguan se si e imagjinojnë përmirësimin e kësaj hapësire.

VËZHGO → DALLO → BISEDË → SUGJERO → VIZATO → PARAQIT

Detyra e tyre nuk ishte të gjenin një zgjidhje “të përsosur” e as ta ndryshonin Pyllin e Pishave me ndërhyrje të mëdha. Përkundrazi, pikënisja ishte ruajtja e asaj që e bën këtë hapësirë të vlefshme, siç janë gjelbërimi, ambienti natyror dhe karakteri i saj publik, si dhe të menduarit se si me ndërhyrje të kujdesshme e të thjeshta ajo mund të bëhet më e qasshme, më e sigurt, më funksionale dhe më e këndshme për të gjithë.

Idetë e paraqitura në faqet në vijim janë pikërisht rezultat i këtij procesi – një vështrim i të rinjve mbi Pyllin e Pishave sot dhe i propozimeve të tyre se si kjo hapësirë e vlefshme publike e Ulqinit mund të bëhet edhe më e mirë për njerëzit, duke ruajtur njëkohësisht karakterin e saj natyror.





3.DETYRA

Si ta zhvillojmë hapësirën duke ruajtur vlerat e saj?



Secili grup ka fituar një pjesë të caktuar të Pyllit të Pishave dhe detyrën që për atë pjesë të mendojë një zgjidhje ideale për përmirësimin e saj. Zgjidhja nuk duhej të ndryshonte qëllimin thelbësor dhe karakterin e hapësirës, por përmes intervenimeve të vogla, të thjeshta dhe kreative të përmirësonte mënyrën se si përdoret hapësira.

Gjatë përpilimit të propozimeve të tyre, nxënësit u udhëhoqën nga pesë parime bazë:

1.RUAJTJA

Ruajtja e karakterit ekzistues të Pyllit të Pishave, gjelbërimit dhe vlerave të tij natyrore.

2.FUNKSIONALITETI

Të propozohen ndërhyrje të vogla dhe të mençura që e bëjnë hapësirën më cilësore dhe më të këndshme për përdorim.

3.INKLUZIONI

Të mendohet për një hapësirë për të gjithë – të rinjtë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara – pa pengesa fizike dhe shoqërore.

4.SIGURIA


Të kushtohet vëmendje të pjesët e pjerrëta dhe të rrezikshme, siguria e fëmijëve, ndriçimi dhe rreziqet e tjera të mundshme.

5.QËNDRUESHMËRIA DHE KREATIVITETI

Të propozohen zgjidhje bashkëkohore dhe kreative që nuk e dëmtojnë natyrën dhe që përdorin qasje ekologjike të favorshme.

Qëllimi i përbashkët i të gjitha propozimeve ishte i thjeshtë:

Një hapësirë gjithëpërfshirëse, e sigurt, funksionale, e lidhur dhe në harmoni me natyrën.





PARIME TË RËNDËSISHME (TË DETYRUESHME)

RUAJTJA E KARAKTERIT TË HAPËSIRËS

- Hapësira ruan funksionin dhe identitetin e saj themelor
- Nuk ka ndryshime rrënjësore të destinimit

NDËRHJRJE TË THJESHTA DHE TË MENÇURA

- Ndryshime të vogla, por efektive
- Fokus te funksionaliteti dhe cilësia e përdorimit

QASJE BASHKËKOHORE DHE INOVATIVE

- Zgjidhje kreative të përshtatura për të rinjtë
- Elemente fleksibile dhe shumëfunksionale

GJITHËPËRFSHIRJA

- Hapësira duhet të jetë e qasshme për të gjithë
- Pa barriera (fizike dhe shoqërore)

QËNDRUESHMËRIA DHE MBROJTJA E NATYRËS

- Të mos rrezikohen gjelbërimi ekzistues dhe elementet natyrore
- Të përdoren zgjidhje ekologjike të pranueshme
- Të nxitet qëndrimi në natyrë dhe rëndësia e saj


4. IDETË E TË RINJVE



GRUPI I – OAZA E GJELBËR E SHËNDETËSISË



GRUPI II – ECO DRAMA QUEENS



GRUPI III – SHTEGU I JETËS - 1



GRUPI IV – SHTEGU I JETËS - 2

GRUPI I

OAZA E GJELBËR E SHËNDETËSISË



Edona, Diellza dhe Natalija

Grupi e ka përqendruar punën e vet në hapësirën e gjelbër, nga restoranti Sapore di Mare e deri te Plazhi i Grave, duke e identifikuar atë si një hapësirë me plot vlera natyrore, e cila sot nuk është e rregulluar mjaftueshëm e as e sigurt për t'u shfrytëzuar. Ato vunë në dukje veçanërisht palestrën e lënë pas dore në natyrë, pajisjet e dëmtuara dhe të ndryshkura, ndenjëset e pasigurta, qasjen e vështirësuar dhe pemët e rrëzuara.

Ideja e tyre, e emërtuar „Oaza e gjelbër e shëndetit“, niset nga fakti se hapësira fillimisht duhet të pastrohet dhe të rregullohet, por duke ruajtur maksimalisht natyrën ekzistuese. Ato propozuan rindërtimin e palestrës me pajisje të reja dhe të sigurta, rregullimin e Shtegut të Poezisë me ulëse e tavolina, një bibliotekë të vogël të hapur, si dhe krijimin e një këndi për shoqërim e piknik me tavolina shahu dhe përmbajtje të tjera për fëmijë e të rritur.

Një pjesë veçanërisht interesante e propozimit të tyre është përdorimi i drurit të rrëzuar për ndërtimin e ulëseve, tavolinave, shportave të mbeturinave, shtëpizave për shpendë dhe elementeve të tjera, me ç'rast ajo që tashmë ekziston në hapësirë merr një qëllim të ri.

Përmes skicave të tyre, nxënëset e kanë konceptuar Pyllin e Pishave si një vend për rekreacion, pushim, lexim, lojë dhe shoqërim – të rregulluar dhe të sigurt, por gjithmonë natyror.



Vizatimet: Edona Ramoviq dhe Diellza Sukaliq

GRUPI II

ECO DRAMA QUEENS

Sara, Behudina dhe Rialda

Grupi e ka përqendruar propozimin e vet në hapësirën e gjelbër nën hotelin Albatros, e cila sot përdoret pjesërisht si një vendparkim i parregulluar dhe kalim, edhe pse, sipas mendimit të tyre, ka një potencial shumë më të madh. Ideja e tyre është që kjo hapësirë e lënë pas dore të shndërrohet në një eko-park të vogël i përshtatshëm për të gjitha gjeneratat, duke ruajtur natyrën dhe me sa më pak ndërhyrje në ambientin ekzistues.

Fokus të veçantë i kanë kushtuar qasshmërisë.

Ato propozojnë rregullimin e shtigjeve nga materialet natyrore e të përshkueshme nga uji dhe të pistave të pjerrëta prej druri, në mënyrë që hapësira të jetë e qasshme edhe për personat me aftësi të kufizuara dhe për prindërit me karroca fëmijësh. Koncepti i tyre përfshin një zonë aventure dhe eko-parkuri për të rinjtë, hapësira të rregulluara për pushim me ulëse e shezllongje prej paletash, rrjeta varëse, koshe mbeturinash dhe ushqyesë për shpendë të punuar nga materialet e ricikluara.

Përmes vizatimeve të Sarës është paraqitur vizioni i përbashkët i grupit – një hapësirë ku aventura, shoqërimi dhe pushimi lidhen me natyrën, ndërsa relievi ekzistues dhe gjelbërimi bëhen pjesë e përmbajtjes, në vend që të jenë pengesë.

Ideja e tyre tregon se si një hapësirë publike e lënë pas dore mund të rigjallërohet dhe të bëhet më tërheqëse për të rinjtë, ndërkohë që mbetet e qasshme dhe e këndshme për të gjithë.



GRUPI III

SHTEGU I JETËS - 1

Angjella, Gjorgje dhe Medina


Grupi e ka quajtur punimin e vet „Shtegu i jetës“, me idenë që një pjesë e Pyllit të Pishave të përmirësohet, por mbi të gjitha të ruajë karakterin e vet natyror.

Vizioni i tyre është një hapësirë që lidh njerëz të gjeneratave të ndryshme, nxit qëndrimin dhe shoqërimin në natyrë, duke ruajtur njëkohësisht biodiversitetin. Prandaj, ata sugjerojnë vetëm ndërhyrje minimale dhe të mirëmenduara.

Propozimi i tyre përfshin një zonë për pushim dhe shoqërim, pistën e çiklistëve, pika vëzhgimi prej druri, tabela informuese edukative-argëtuese, shtëpiza për shpendë dhe kroje me ujë.

Angjella, Gjorgje dhe Medina nëpërmjet punës së tyre dërgojnë një mesazh të thjeshtë:

Pylli i Pishave duhet të përmirësohet në mënyrë që ta shfrytëzojmë dhe të qëndrojmë në të sa më shumë, por pa e humbur atë që e bën të posaçëm – natyrën, gjelbërimin dhe ambientin e tij shërues.



Vizatimi: Angjella Pekiq

Idetë tona

- ZONË PËR PUSHIM DHE SOCIALIZIM
- KORSI PËR BIÇIKLETA
- PIKA VËZHGIMI PREJ DRURI (PHOTO-SPOT)
- TABELA EDUKATIVE DHE ARGËTUESE INFO
- VENDOSJA E SHTËPIZAVE PËR ZOQJ
- VENDOSJA E BURIMEVE TË UJIT (ÇEZMAVE)



GRUPI IV

SHTEGU I JETËS - 2

Emina dhe Emiri

Emina dhe Emiri propozimin e tyre e kanë përqendruar në rregullimin e Pyllit të Pishave si një hapësirë funksionale, të sigurt dhe të qëndrueshme për këmbësorët.

Ata kanë identifikuar veçanërisht mungesën e trotuarit përgjatë rrugës kryesore dhe nevojën për kushte më të mira për lëvizje nëpër këtë hapësirë.

Idetë e tyre përfshijnë vendosjen e ulëseve në vende me pamje nga deti, të shportave të mbeturinave, si dhe vendosjen e ndriçimit diellor. Një fokus të rëndësishëm i kanë kushtuar ruajtjes dhe ringjalljes së gjelbërimit përmes mbjelljes së pishave të reja dhe mirëmbajtjes së atyre ekzistuese, duke ruajtur kështu ekosistemin natyror.

Poashtu, vëmendje të veçantë Emina dhe Emiri i kanë kushtuar sigurisë, duke sugjeruar vendosjen e gardheve mbrojtëse në pjesët e rrezikshme të shtegut përgjatë pjerrësive të thikta.

Punimi i tyre tregon se si me pak ndërhyrje konkrete Pylli i Pishave mund të bëhet më i rregulluar, më i sigurt dhe më i këndshëm për shëtitje të përditshme dhe qëndrim në natyrë.

Ndërtimi i gardheve mbrojtëse në zonat e rrezikshme, me gjatësi prej së paku 1.3 m dhe nga materiale që nuk ndryshken dhe janë të qëndrueshme.




Vizualizimi: Emir Kaleziq



Vizatimi Emina Telletoviq



Vizatimi Emina Telletoviq



5. NDËRHJRJE TË VOGLA - NDRYSHIME TË MËDHA TË RINJTË KANË ÇFARË TË THONË

Kur të gjitha propozimet vendosen krah për krah, shihet se të rinjtë nuk kanë kërkuar projekte spektakolare. Katër grupet kanë ofruar ide të ndryshme, por përmes të gjitha punimeve të tyre përcillet i njëjti mesazh: **Pyllin e Pishave nuk duhet ta ndryshojmë – duhet ta ruajmë dhe ta bëjmë më të mirë për të gjithë.**

Të rinjtë nuk kanë propozuar ndërhyrje të mëdha e as ndërtime të reja.

Ata kanë identifikuar vlerën e hapësirës që tashmë ekziston dhe kanë menduar se si me ndërhyrje të thjeshta ta bëjnë atë më të rregulluar, më të sigurt, më të qasshme dhe më të këndshme për qëndrim.

Në propozimet e tyre, Pylli i Pishave mbetet para se gjithash **një hapësirë natyrore dhe publike.**

Një vend për shëtitje, pushim, shoqërim dhe rekreacion, duke ruajtur gjelbërimin, ambientin natyror dhe lidhjen e tij të veçantë me detin.

Mbase pikërisht ky është mesazhi më i rëndësishëm i punimeve të tyre: ***një hapësirë e mirë publike nuk ka pse të ndërtohet gjithmonë nga e para.*** Ndonjëherë mjafton të njihet vlera e asaj që tashmë e kemi, ta ruajmë atë, të kujdesemi për të dhe ta bëjmë më të qasshme për njerëzit që e shfrytëzojnë.

Punimet e prezantuara në këtë publikim nuk janë projekte të përfunduara urbanistike apo arkitektonike, e as nuk ka qenë ky qëllimi i tyre.

Këto janë idetë e të rinjve për hapësirën dhe qytetin ku ata jetojnë. Vlera e tyre nuk është vetëm në zgjidhjet e skicuara, por edhe në pyetjet që ato parashtruan:

Kujt i përket hapësira publike?

Kush e shfrytëzon atë sot, e për kë nuk është mjaftueshmërisht e qasshme?

Çfarë i mungon asaj?

Çfarë duhet të ruhet?

Si mund ta bëjmë atë më të mirë së bashku?

Pasi të rinjtë nuk janë vetëm përdoruesit e ardhshëm të qytetit. Ata e shfrytëzojnë dhe e jetojnë atë sot.

Prandaj, ata duhet të kenë mundësinë të vëzhgojnë, të pyesin, të propozojnë dhe të marrin pjesë në diskutimin se çfarë hapësire publike dhe çfarë qyteti dëshirojnë.

PJESËMARRËSIT DHE MENTORIMI

Publikimi „Hapësira publike nga prizmi i të rinjve“ është krijuar përmes punës së përbashkët me nxënësit e SHMK „Vëllazërim-bashkim“ në Ulqin, të cilët përmes katër grupeve hulumtuan hapësirën e Pyllit të Pishave dhe zhvilluan idetë e tyre për përmirësimin e tij.

PJESËMARRËSIT:

Natalija Marniković, Edona Ramović, Diellza Sukaliq, Sara Suleviq, Behudina Kovaç, Rialda Karagjuzović, Angjella Pekiq, Gjorgje Lleković, Medina Telletoviq, Emina Telletoviq dhe Emir Kaleziq.

MENTORIMI – EKIPI MSJA:


Zenepa Lika, inxhinierë e diplomuar e arkitekturës
Haxhere Gjenasheviq
Mensur Pelinković

I falënderojmë të gjithë nxënësit për pjesëmarrjen, kreativitetin dhe idetë e tyre, por mbi të gjitha për gatishmërinë që hapësirën publike të qytetit të tyre ta vëzhgojnë me vëmendje, me syrin kritik dhe me dëshirën për ta bërë atë më të mirë për të gjithë.

MBI PUBLIKIMIN

Publikimi „Hapësira publike nga prizmi i të rinjve“ ka lindur në kuadër të projektit “Rojtarët kreativë dhe zëri i komunitetit për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Ulqinit”, të cilin e realizon Shoqata „Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc – MSJA“, ndërsa e financon Fondacioni European për Demokraci – EED.

Qëndrimet dhe opinionet e shprehura u përkasin vetëm autorëve dhe nuk pasqyrojnë nevojshmërisht qëndrimet e donatorit.



Vizatimi: Sara Suleviq

MSJA

Ulqin, 2026